

Vendim nr. 37 datë 22.02.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Marjana Semini, Anëtare

Sandër Beci, Anëtar

në datën 22.02.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 6 (G) 2022 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: GËZIM VASI

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 00-2022-825, datë 07.07.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; nr. 20-2016-363/81, datë 11.04.2016 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë; nr. 21-2015-1997(413) datë 03.12.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 148 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë në datën 09.10.2014 ka regjistruar procedimin penal nr. 778 të vitit 2014 për ngjarjen e vjedhjes me dhunë të një shtetasi në datën 09.10.2014 në qytetin e Gjirokastrës. Në përfundim të hetimit paraprak, prokuroria ka paraqitur për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë kërkesën që i përket çështjes penale në ngarkim të pandehurve Gëzim Vasi (kërkuesi) dhe A.B., të akuzuar për veprën penale “Vjedhja me dhunë”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 139 dhe 25 të Kodit Penal (KP), R.Ç. dhe D.T., të akuzuar për veprën penale “Moskallëzimi i krimit”, të parashikuar nga neni 300 i KP-së, si dhe L.V., i akuzuar për veprën penale “Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës”, të parashikuar nga neni 301 i KP-së.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. 21-2015-1997(413) datë 03.12.2015, ka vendosur: *“Deklarimin fajtor të të pandehurit Gëzim Vasi për veprën penale ‘Vjedhja me dhunë’, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 139 e 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 12 (dymbëdhjetë) vjet burgim. Vuajtja e dënimit fillon nga data e ndalimit 20.10.2014 dhe të kryhet në burg të sigurisë së zakonshme....”*. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka ushtruar apel.

3. Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr. 20-2016-363/81, datë 11.04.2016, ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. 21-2015-1997 (413), datë 03.12.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, për sa i përket disponimeve për të pandehurit Gëzim Vasi, ..., si dhe për disponimin për shpenzimet gjyqësore.”*.

4. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, në datën 10.05.2016 ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë kërkuesi, i cili në datën 09.06.2022 ka paraqitur edhe një memorie me shkrim, duke pretenduar se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe vendimi i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, e cila ka lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë, nuk janë të drejta, pasi nuk janë të bazuara në ligj dhe në prova, por në deklaratimet e dëshmitarëve që kishte parapërgatitur oficeri i Policisë Gjyqësore. Nuk ka asnjë provë tjetër bindëse për ushtrim të dhunës fizike dhe psikologjike dhe për elementin e bashkëpunimit, pasi nuk ka pasur përleshje, ndërkohë që kërkuesi ka qenë në gjendje të dehur dhe i vetëm. Për rrjedhojë, ato gjykata kanë cilësuar gabim veprën penale, duke caktuar ndaj kërkuesit një dënim shumë të rëndë.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022- 825, datë 07.07.2022, ka vendosur: *“Mospranimin e rekurseve të paraqitura nga të gjykuarit L.V., A.B. dhe Gëzim Vasi, kundër vendimit me nr. 20-2016-363/81, datë 11.04.2016 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.”*. Në këtë vendim, Gjykata e Lartë ka arsyetuar: *“[...] të gjykuarit kanë parashtruar disa pretendime që lidhen me mënyrën e vlerësimit/çmuarjes së provave nga gjykatat e faktit. ... pjesa e pretendimeve*

në rekurs që ngre çështje të vlerësimit të provave (të shqyrtuara nga gjykatat e faktit në zbatim të nenit 152 të KPP, mbi të cilat është vendosur deklarimi fajtor i të gjykuarve), del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë. ... Pavarësisht sa më lart, në referim të rekursit të paraqitur nga rekursuesit, ... Gjykata e Apelit Gjirokastrë, në zbatim të nenit 152 të KPP, ka vlerësuar dhe analizuar provat në tërësi dhe në lidhje me njëra tjetrën, duke mos i dhënë vlerë të paracaktuar dhe mbivlerësuar asnjë prej provave që janë lejuar dhe marrë në këtë gjykim. Gjykimi i kësaj çështje penale nga gjykatat e faktit është zhvilluar sipas procedurës së zakonshme, ku çdo provë është marrë dhe është verifikuar në seancë gjyqësore, duke ju nënshtruar debatit gjyqësor, në përputhje me parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit. Kolegji vlerëson se gjykata e apelit i ka dhënë përgjigje të mirëargumentuar pretendimeve të rekursuesve, si në drejtim të çmuarjes së provave, ashtu edhe në lidhje me pretendimet për pavlefshmëri të akteve dhe papërdorshmëri të provave. ... Gjykata e Lartë është një gjykatë ligji, të cilës palët mund t'i drejtohen vetëm për shkaqet e përcaktuara në nenin 432 të KPP. Rekursuesit L.V., A.B. dhe Gëzim Vasi nuk kanë argumentuar nëse nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë është cenuar ligji penal (material ose procedural); nuk janë evidentuar shkelje që kanë si pasojë pavlefshmërinë absolute të vendimit, sipas nenit 128 të KPP; si dhe nuk parashtruar shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit apo që vendimi i rekursuar vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal apo Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, referuar shkaqeve të rekursit të parashikuar nga neni 432 i KPP. ... rekursi i paraqitur nga të gjykuarit L.V., A.B. dhe Gëzim Vasi, kundër vendimit me nr. 20-2016-363/81, datë 11.04.2016 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë nuk duhet të pranohet, pasi nuk përmban asnjë nga shkaqet që parashikohen në nenin 432 të KPP.” (shih paragrafët 21, 22, 23 dhe 25 të vendimit nr. 00-2022- 825, datë 07.07.2022 të Gjykatës së Lartë).

6. Në datën 09.11.2022 kërkuesi i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore të të tria shkallëve të gjykimit si të papajtueshme me Kushtetutën.

II

Pretendimet e kërkuesit

7. **Kërkuesi** ka pretenduar se vendimet e të tria shkallëve të gjykimit, objekt i ankimit kushtetues individual, kanë cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor në drejtim të:

7.1. Së drejtës për një gjykim të drejtë dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit, pasi gjykatat, duke mos e shqyrtuar çështjen sipas procedurës së gjykimit të shkurtuar të kërkuar nga kërkuesi, i kanë mohuar përfitimin e uljes së dënimit me

një të tretën e masës së tij. Gjykatat, edhe pse e kanë shqyrtuar çështjen sipas procedurës së gjykimit të zakonshëm, nuk janë thelluar në hetimin e saj për të plotësuar dosjen gjyqësore me ato prova që do të vërtetonin dëmtimet trupore të viktimës dhe, për rrjedhojë, përlëshjen mes tij dhe kërkuesit, as shumën e parave që dispononte ai në momentin e ngjarjes, si dhe elementet e bashkëpunimit. Ato u kanë dhënë vlerë të paracaktuar, si dhe kanë mbivlerësuar disa prej provave që janë lejuar dhe marrë në këtë gjykim. Po kështu, gjykatat, duke cilësuar gabim veprën penale për rrethanat e ngjarjes në fjalë, kanë caktuar një masë përfundimtare të dënimit tepër të rëndë dhe në raport të zhdrejtë me rrezikshmërinë e veprës penale dhe të autorit të saj, me shkallën e fajësisë së tij, si dhe me rrethanat lehtësuese e rënduese, pasi, përveçse është vetëdorëzuar në polici dhe ka bashkëpunuar me organin procedues përgjatë hetimit, ka shfaqur pendesë për veprimet e tij në atë ngjarje.

7.2. *Së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme*, pasi gjykatat janë bazuar në deklaratimet e dëshmitarëve që kishte parapërgatitur oficeri i Policisë Gjyqësore, për të cilin ka paraqitur kallëzim penal për shkak se në njërin prej tyre është falsifikuar nënshkrimi i deklarueses. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr. 23-2022-504, datë 31.03.2022, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për këtë kallëzim dhe çështja është ende në shqyrtim.

7.3. *Standardit të arsyetimit të vendimit*, pasi Gjykata e Lartë ndonëse në rekursin e datës 10.05.2016 dhe në memorien e datës 09.06.2022 ishin parashtruar pretendime për pavlefshmërinë e akteve procedurale dhe papërdorshmërinë e provave, për shkeljen e së drejtës për gjykim të shkurtuar, për shkeljen e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit gjatë procedurës së gjykimit të zakonshëm, si dhe për caktimin e dënimit përfundimtar në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit, nuk i ka vlerësuar, duke mos dhënë përgjigje të arsyetuara për to

III

Vlerësimi i Kolegjit

8. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje

Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

9. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

10. Kolegji vlerëson se kërkuuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

11. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individ mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Qëllimi i këtij neni të Kushtetutës është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatën Kushtetuese (*shih vendimin nr. 12, datë 24.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, ajo mund të kërkohej vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor. Cenimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të jenë shteruar të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelineve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuuesi ka kërkuar shfuqizimin e vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë dhe të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me pretendimin se ato i kanë cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor në aspektet e së drejtës për një gjykim të drejtë dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit, së drejtës për një hetim të plotë e të gjithanshëm, së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, si dhe standardit të arsyetimit të vendimit, të garantuara nga nenet 42, 17 dhe 32 të Kushtetutës. Për këto pretendime kërkuuesi nuk ka mjete të

tjera ankimi, për rrjedhojë ai ka plotësuar kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës.

13. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi procesi gjyqësor i kundërshtuar ka përfunduar me vendimin e datës 07.07.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i cili ka qenë i disponueshëm për palët në datën 27.09.2022, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 09.11.2022, pra brenda afatit ligjor 4 - mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

14. Për sa i takon legjitimitetit *ratione materiae*, Kolegji thekson se sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kushtetutë, kur pasojat negative janë të drejtpërdrejta dhe reale për kërkuesin dhe shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur.

15. Në jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës është theksuar se vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe interpretimi i ligjit janë kompetenca të gjykatave të sistemit gjyqësor të zakonshëm, por Gjykata mund t’i marrë në konsideratë vetëm nëse përmes këtij procesi cenohen të drejta kushtetuese themelore, duke bërë vlerësim të natyrës kushtetuese të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022; nr.7, datë 07.02.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në këtë pikëpamje, Kolegji çmon se pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në aspektet e së drejtës për një gjykim të drejtë dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit, kanë të bëjnë me vlerësimin e fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe me interpretimin e ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, për rrjedhojë nuk do të trajtohen. Për sa iu takon pretendimeve për cenimin e së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme dhe së drejtës për një vendim gjyqësor të arsyetuar, *prima facie* hyjnë në juridiksionin kushtetues dhe, si të tilla, do të analizohen vijim.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme

17. Kërkuesi ka pretenduar se gjykatat janë bazuar në deklaratimet e dëshmitarëve që kishte parapërgatitur oficeri i Policisë Gjyqësore, për të cilin ka paraqitur kallëzim penal, pasi në njërën prej tyre është falsifikuar nënshkrimi i deklarueses. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr. 23-2022-504, datë 31.03.2022, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për këtë kallëzim dhe çështja është ende në shqyrtim. Ai ka parashtruar se, pasi ka siguruar një kopje të dosjes gjyqësore të çështjes së tij nga Gjykata e Lartë, ka konstatuar se gjykatat e ulëta kanë

vlerësuar deklaratimet e dëshmitarëve, disa prej të cilave të përgatitur nga oficeri i Policisë Gjyqësore, ndër të cilat edhe ai i shtetases I.T., me nënshkrim të falsifikuar, pasi në datën e deklaratimit ajo ndodhej jashtë shtetit. Mbi këtë bazë, kërkuesi ka paraqitur kallëzim penal, për të cilin prokuroria ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Gjykata e shkallës së parë, në bazë të ankimit të kërkuesit, ka vendosur ta pranojë atë, duke urdhëruar prokurorinë që të regjistrojë procedimin penal dhe të kryejë hetimet e nevojshme.

18. Sipas nenit 32, pika 2, të Kushtetutës askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Marrja e provave në mënyrë të ligjshme përbën një aspekt të rëndësishëm të respektimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Në këtë drejtim, detyra e Gjykatës është të vlerësojë nëse procesi si i tërë, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave, ka qenë i drejtë. Për të përcaktuar nëse procesi ka qenë i rregullt, duhet kontrolluar nëse e drejta e mbrojtjes është respektuar dhe duhet verifikuar në veçanti nëse kërkuesit i është dhënë mundësia për të vënë në dyshim autenticitetin e provave dhe kundërshtuar përdorimin e tyre (*shih vendimin nr. 57, datë 21.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Po kështu, në jurisprudencën kushtetuese është evidentuar dallimi që ekziston midis mënyrës së marrjes të provave dhe vlerësimit të tyre në procesin gjyqësor. Vlerësimi, dobishmëria dhe rëndësia e tyre provuese në një çështje konkrete është, si rregull, detyrë e gjykatave të sistemit gjyqësor, ndërsa verifikimi i ligjshmërisë së krijimit dhe marrjes së provave i nënshtrohet edhe kontrollit të kësaj Gjykate, pasi ky aspekt i gjykimit ka lidhje të drejtpërdrejtë me procesin e rregullt ligjor. Gjykata mund dhe duhet të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për mënyrën e marrjes së provave, por jo të vlerësimit të tyre. Është vetë gjykata e zakonshme që vlerëson nëse provat duhet të merren dhe mënyra e vlerësimit dhe konkluzionet lidhur me to janë, gjithashtu, në kompetencë të saj. Parimi i barazisë së armëve nuk u imponon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm që të pranojnë të gjitha argumentet dhe provat që paraqet një palë në proces. Kur kryen detyrën e saj të vlerësimit të lirë të provave, gjykata e zakonshme mund të bindet mbi bazën e disa provave, duke përjashtuar një ose disa prova të tjera, që ajo i konsideron të parëndësishme për çështjen (*shih vendimet nr. 19, datë 01.04.2021; nr. 21, datë 20.03.2017; nr. 19, datë 19.07.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Kolegji, referuar akteve në dosje, konstaton se pretendimi i kërkuesit se ai është njohur për herë të parë me aktin e kundërshtuar në Gjykatën e Lartë nuk qëndron. Në fakt, kërkuesi gjatë gjykimit në shkallë të parë ka kërkuar gjykim të shkurtuar, që do të thotë se është njohur me aktet e çështjes dhe nuk ka pasur ndonjë kundërshtim për to. Për më tepër, në faza të ndryshme të

procedimit penal atij i është dhënë mundësia për të parashtruar pretendimet në lidhje me mangësitë e provave nga ana formale, si dhe për të kundërshtuar autenticitetin dhe ligjshmërinë e tyre. Gjithashtu, Kolegji vëren se Gjykata e Lartë i ka dhënë përgjigje të arsyetuar këtij pretendimi me natyrë kushtetuese të kërkuarit, duke u shprehur se “vendimi me nr. 23-2022-504, datë 31.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë nuk ndikon në çështjen objekt rekursi, pasi në radhë të parë ai nuk është një vendimi gjyqësor themeli i formës së prerë; në radhë të dytë, me këtë disponim gjykata ka urdhëruar regjistrimin e një procedimi penal, fakt që nuk nënkupton se fakti penal i pretenduar nga kallëzuesi është i dokumentuar apo i provuar; e në radhë të tretë, edhe nëse në përfundim të një gjykimi penal do të provoheshin pretendimet e kallëzuesit/të gjykuarit Gëzim Vasi (pra nëse do të kemi një vendim penal themeli mbi faktin e falsifikimit të pretenduar), vendimi gjyqësor i formës së prerë mund të përdorej si provë për të mbështetur një kërkesë për rishikim sipas nenit 449 e vijues të KPP-së. Gjykata e Lartë është një gjykatë ligji, që nuk vlerëson apo nuk merr prova që lidhen me procesin e të provuarit të faktit penal” (shih paragrafin 24 të vendimit nr. 00-2022- 825, datë 07.07.2022 të Gjykatës së Lartë).

21. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës për t’u mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, është haptazi i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit

22. Kërkuari ka pretenduar cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ndonëse në rekursin e datës 10.05.2016 dhe në memorien e datës 09.06.2022 ishin parashtruar pretendime për pavlefshmërinë e akteve procedurale dhe papërdorshmërinë e provave, për shkeljen e së drejtës për gjykim të shkurtuar, për shkeljen e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit gjatë procedurës së gjyqimit të zakonshëm, si dhe për caktimin e dënimit përfundimtar në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit, nuk i vlerësuar, duke mos dhënë përgjigje të arsyetuara për to.

23. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (shih vendimin nr. 21, datë 26.09.2022 të Gjykatës Kushtetuese). Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse

janë të lidhura ngushtësisht mes tyre (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata, rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe, në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimin nr. 12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa u përket vendimeve të dhomës së këshillimit të Gjykatës së Lartë, jurisprudenca kushtetuese ka pranuar se kërkesat e një procesi të rregullt ligjor mund të plotësohen edhe me një arsyetim të kufizuar të tyre, kur në pjesën hyrëse të vendimit janë listuar shkaqet e rekursit (*shih vendimet nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018; nr. 8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në referim të rastit konkret, Kolegji konstaton se në pjesën hyrëse vendimi i Gjykatës së Lartë përmban pretendimet e parashtruara nga kërkuesi në rekursin e datës 10.05.2016 dhe në memorien e datës 09.06.2022, të cilat janë marrë në shqyrtim dhe u është dhënë përgjigje e arsyetuar nga Kolegji Penal. Ky vendim paraqitet i rregullt në formë, i qartë, koherent dhe pa kundërtënie në përmbajtje. Ai pasqyron në mënyrë të plotë rrethanat e çështjes, shkaqet e rekursit dhe vlerësimin e Kolegjit në vështrim të nenit 432 të KPP-së në lidhje me këto shkaqe.

26. Për rrjedhojë, edhe pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit është haptazi i pabazuar.

27. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues i kërkuesit nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31, pika 2 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “a” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.